

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetar, Afrim Shala dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.Gj., nga fshati ..., ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarit R.A., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.921/2017, i datës 5 prill 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 12 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit R.A., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.921/2017, i datës 5 prill 2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin F.Gj., nga fshati ..., ..., Komuna e Pejës, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim i pandehuri është detyruar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në qoftë se dënimin më gjobë i pandehuri nuk e paguan në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë do t'i shndërrohet në dënim me burgim, duke ju llogaritur 1 (një) ditë burgim për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë.

Është detyruar i pandehuri F.Gj., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë Euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

I dëmtuari R.A., nga fshati ..., ..., Komuna e Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i dëmtuari R.A., për shkak të vendimit mbi shqiptimin e sanksionit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër, apo të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Ndaj ankesës së të dëmtuarit, përgjigje në ankesë ka paraqitur i akuzuari F.Gj., i cili ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit të hudhet si e palejuar apo të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/II.nr.529/2018, të datës 22 maj 2018, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i ashpër apo çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës dhe analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se:

- ankesa është e pabazuar.

Sa i përket vendimit për dënimin, në ankesën e të dëmtuarit R.A., theksohet se me veprimet e të dëmtuarit nuk është nxitur i pandehuri që ta kryejë veprën penale, në njëërën anë, kurse në anën tjetër, i dëmtuari si person asnjë herë në jetën e tij nuk ka patur kurrfarë problemi me ndonjë person tjetër apo fqinjë të tij e as me të pandehurin F.Gj.. E gjithë kjo sjellje të pandehurit ka ndikuar negativisht tek komuniteti boshnjak, të cilit i përket edhe vetë i dëmtuari. Dënimin kaq të butë të shqiptuar ndaj të pandehurit, i dëmtuari e ka përjetuar rëndë, për shkak të lëndimeve dhe shpenzimeve të shkaktuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimi i lartcekur i paraqitur në ankesën e të dëmtuarit është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, siç parashihet në nenet 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të pandehurin janë marrë për bazë pranimi i fajësisë, pendimi i të pandehurit për kryerjen e veprës penale, se më parë i njejtë nuk kishte qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe premtimin e tij se në të ardhmën nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa, nuk kishte gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit F.Gj., është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat

e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sa i përket disa pretendimeve tjera të paraqitura në ankesën e të dëmtuarit R.A., që i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në një mënyrë edhe shkeljes së ligjit penal, ato pretendime nuk kanë qenë objekt shqyrtimi, ngase duke u bazuar në nenin 381 paragrafi 3 të KPP, i dëmtuari ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për vepra penale të natyrës së tillë, vetëm sa i përket vendimit të gjykatës lidhur me dënimin. Në anën tjetër, shkeljet për të cilat pretendohet në ankesë, nuk janë të asaj natyre, për të cilat Gjykata e Apelit e Kosovës kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.522/2018, Më 12 qershor 2018

Procesmbajtësi,
Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Shqipe Qerimi

Ferit Osmani